


Prioritetet për KREJT qytetarët DREJT së ardhmes

Shkurt - 2021



127

E TASHMJA



Të dashur qytetarë të Republikës,

Jam edhe i gëzuar, përveçse i nderuar, që po ju drejtohem Juve, në fillim të kësaj fushate për zgjedhjet e reja e të parakohshme. Krejt bashkë ecim drejt 14 shkurtit që e duam si datë të referendumit gjithëpopullor. Sfida është e madhe, por vullneti ynë edhe më i madh. Ta bëjmë shumicën e tanishme popullore në shumicë të ardhshme parlamentare në legjislaturën e tetë. Sepse, ta nxjerrim Kosovën nga kriza e shumëfishtë e ta vendosim në binarët e progresit.

E tashmja jonë prej që u shfaq rasti i parë me COVID-19 te ne është ajo e një situatë të jashtëzakonshme. Jemi 324 ditë prej momentit të parë. Dimë më shumë dhe padyshim mundemi më shumë. Por mbi të gjitha dimë se çka është gabim e që nuk duhet ndjekur. Shërimi e kurimi i sëmundjeve që i patëm në mbrojtje të jetës e shëndetit nuk kanë alternativë. Andaj duhen krijuar kushtet ku shpjegimet dhe rekomandimet e ekspertëve do të jenë bazë për çdo vendim që merret nga institucionet. Pa vonesë do të vemë në zbatim planin aksional të detajuar, i mbështetur financiarisht e i bazuar në situatën në terren.

Masat e veprimet e menjëhershme do të jenë:

- Vaksinimi i së paku 60% të popullatës, sigurimi i qëndrueshëm i materialeve elementare mbrojtëse, barnave dhe testeve, trajnim i vazhdueshëm i stafit shëndetësor, komunikim transparent, i sinqertë dhe i dendur me qytetarët.
- Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve në kujdesin parësor shëndetësor me qëllim edukimin, mesazhet, triazhimin dhe përcjelljen e vazhdueshme të rasteve pa komplikime shëndetësore.
- Do të fillojnë menjëherë bisedimet me vendet e rajonit, me theks të veçantë Shqipërinë, për përbashkjen e përbashkët me pandeminë COVID-19.

Dhe, pa dyshim, do të përgatitemi dhe aplikojmë për anëtarësim në Organizatën Botërore të shëndetësisë.

Të nderuar qytetarë të Kosovës, një manifestim i fuqishëm i kostos së pandemisë natyrisht se është ndjerë në aktivitetin ekonomik. Ka rënie të ndjeshme të prodhimit, probleme të zinxhirët e prodhimit, vende të humbura të punës dhe rritje të numrit të familjeve që përballen me varfërinë.

Për qeverinë tonë, kthimi i jetës ekonomike në normalitet, është natyrshëm kryeprioriteti i angazhimit në ditët, muajt dhe vitin e parë të qeverisjes. Jo vetëm kthim në normalitet, por edhe përgatitje të të gjithë neve për një mënyrë të re të të bërit biznes. Dhe, për këtë jemi të gatshëm të ofrojmë një intervenim ambicioz fiskal.

Synojmë një ekonomi e cila del nga pandemia, e shëruar edhe nga shumë sëmundje të tjera që e kanë përcjellë deri më tani. Një ekonomi ku ka më shumë nevojë e hapësirë edhe për gratë, për rininë, për mërgatën, për komunitetet, për fshatin, e sidomos për ata që kanë nevojë për më shumë mbështetje prej shoqërisë e shtetit. Një ekonomi ku ka më shumë prodhim e më shumë eksport, më shumë punëtorë, më shumë kontrata të punës, e më shumë respektim të të drejtave të punëtorit. Një ekonomi, nga progresi i së cilës përfitojnë shumë më shumë nga ne, një ekonomi

pa monopole, e me ndërmarrje publike që operojnë suksesshëm. Një ekonomi ku edhe komuna fuqizohet dhe vendosë vet për prioritetet e saj.

Ndërmarrësve tanë i ofrojmë qasje shumë të volitshme në financa aq të nevojshme për të përballuar rritjen e prodhimit. Për këtë do të krijojmë partneritet të fuqishëm mes pesë shtyllave që së bashku e garantojnë daljen relativisht të shpejtë nga recesioni i tanishëm: ndërmarrjet - shteti – sistemi bankar – Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive – dhe komuniteti i donatorëve e i kredidhënësve ndërkombëtarë.

Mbështetja do të shtohet për të gjitha bizneset që arrijnë të krijojnë qasje në tregje të reja ndërkombëtare dhe të rrisin eksportet e Kosovës; për të gjithë ndërmarrësit që hapin linja të reja të prodhimit, fusin produkte të reja apo, çka është në qendër të angazhimit tonë si qeveri, arrijnë të shtojnë numrin e punëtorëve.

Ruajtja dhe rritja e numrit të punëmarrësve, sidomos të grave, të rinjve, anëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe familjeve në ndihmë sociale, bashkë me rritjen e formalizimit të punësimit dhe respektimit të të drejtave të punëtorëve, janë prioritate tona jo vetëm në fazën e këndelljes nga pandemia, por edhe përgjatë gjithë periudhës së qeverisjes sonë.

Mbështetje shtesë do ketë për bizneset në sektorë ekonomik që promovojnë efiçencën e energjisë dhe ruajnë ambientin, ndërmarrësit që mundësojnë përpunimin e mëtejshëm të ushqimit, drurit, apo promovojnë turizmin e vendit.

Sektorë si hoteleria, restorantet dhe ofruesit e shërbimeve që janë goditur shumë më shumë nga pandemia do të mbështeten veçmas dhe në varësi të potencialit të tyre për ruajtje dhe rritje të punësimit.

Qeveria jonë do të përkrahë pa kursyer gratë, qoftë përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në fuqinë punëtore, ashtu edhe përmes mbështetjes aktive të saj në ndërmarrësi. Rritja e numrit të bizneseve në pronësi

të grave është parakusht për fuqizimin edhe të ekonomisë. Përmes mbështetjes intensive të rritjes së numrit të fëmijëve në çerdhe do të krijojmë më shumë hapësirë për gratë që të kyçen në tregun e punës, kurse përmes subvencionimit të çerdheve dhe lirimit të tyre nga obligimi për pagesën e tatimit në vlerën e shtuar do të ndihmojmë drejtpërdrejt në rritjen e punësimit të grave.

Rinia është resursi më i çmueshëm dhe njëkohësisht më i nëpërkëmbur i vendit tonë. Kjo do të ndryshojë përfundimisht me qeverinë tonë. Qeveria jonë ka përgatitur një pako intervenimesh që synojnë adresimin e problemit të shkallës së ultë të angazhimit të të rinjve në jetën ekonomike. Kjo pako fillon nga rritja e bursave për studentë që vendosin të orientohen drejt fushave studimore që kërkohen nga tregu i punës; fuqizimi i angazhimit të të rinjve në praktika profesionale, të paguara dhe subvencionuara nga shteti; mbështetja e sistemit arsimor për të ulur hendekun e shkathtësive në tregun e punës, e deri të programet e mëdha dhe atraktive që do mbështesin mijëra iniciativa inovative të të rinjve tanë.

Qeveria jonë nuk mund ta nënvizojë fuqishëm interesimin dhe gatishmërinë e saj për fuqizimin e rolit që duhet të ketë mërgata në ekonominë tonë. Përtej pjesëmarrjes së saj në anën e kërkesës agregate që kujdeset për mirëmbajtjen e sektorit të ndërtimitarisë në vend dhe atë të shërbimeve në muajt e verës, mërgata ka potencial shumëfish më të madh. Nuk do ketë më karton të gjelbërt për mërgatën. Ne do kujdesemi që mërgata të avancohet në mbështetës të fuqishëm të përpjekjeve tona për zhvillim ekonomik e shoqëror si përmes iniciativave private biznesore ashtu edhe përmes kthimit të kapitalit human që do vihej në shërbim të dizenjimit dhe zbatimit të politikave tona ekonomike apo kthimit të eficiencës të ndërmarrrjet tona publike.

Qeveria jonë do të kujdeset që bujku e fshati të mos shfrytëzohet më vetëm në fazë të zgjedhjeve duke alokuar grante e subvencione me linja të mbështetjes partiake. Bujku e fshati do të mbështeten shumë më shumë se me grante e subvencione. Do të fillojmë me futjen e çmimeve referente

për një sërë produktesh bazike bujqësore, midis tyre edhe për grurin dhe gumështin, duke garantuar kështu stabilitet në treg. Do të mbështesim financimin e bujqësisë me kredi që kanë brenda një periudhë pushimi më të gjatë, do të lehtësojmë promovimin e turizmit rural, dhe në afat të mesëm do të kujdesemi që komunat përmes grantit të katërt të kenë më shumë autonomi në promovimin e investimeve në fshat.

Në qeverinë tonë nuk do të ketë vend për asnjë diskriminim në punësim, arsim apo mbështetje për ndërmarrësit, për komunitetet joshumicë. Kemi obligim dhe vullnet që komuniteteve joshumicë t'u hapim të gjitha rrugët dhe mundësitë që të ndihen dhe të jenë jo vetëm të barabartë me secilin qytetar tjetër por edhe bashkëpronar të progresit tonë në ekonomi dhe shoqëri.

Qeveria jonë do të kujdeset që menjëherë të vazhdojmë me procesin e departizimit dhe normalizimit të punës në ndërmarrjet publike aq të goditura si nga pandemia ashtu edhe nga keqmenaxhimi, partizimi e zhvatja e dy dekadave të fundit. Këto ndërmarrje duhet të kalojnë nga pengues në mbështetës të rritjes së ekonomisë së vendit; nga absorbues të buxhetit publik në kontribues të rritjes së tij.

Njëkohësisht do të kujdesemi që sektori publik përmes keqqeverisjes të mos dëmtojë konkurrencën e lirë në ekonomi. Shumë shpejt do të trajtojmë në mënyrë meritore eliminimin e monopoleve në ekonomi dhe do të kujdesemi që fuqia politike të mos mund të keqpërdoret për ridrejtimin e përfitimeve shoqërore drejt një grupi të vogël të përfituesve të padrejtë. Terminalët doganore do i kthejmë aty ku e kanë vendin.

Komunat e Kosovës janë goditur jashtëzakonisht shumë nga periudha e pandemisë dhe do kenë nevojë për mbështetje shtesë. Qeveria jonë do i rri afër komunave si në fazën e rimëkëmbjes ashtu edhe më tej duke fuqizuar atë si bartës të orientimit, implementimit dhe monitorimit të investimeve në nivel komunal.

Qeveria jonë do të kujdeset që asnjëherë më krizat eventuale të mos na gjejnë me rezerva shtetërore të zbrazëta apo plaçkitura. Do të ndajmë mjetet e nevojshme buxhetore për mbushjen e rezervave shtetërore, duke u kujdesur që kryesisht të përdoret ekonomia vendore për furnizimin e tyre.

Për qeverinë tonë një gjë është me shumë rëndësi, kthimi i ekonomisë në normalitet, dhe, mbështetja e rritjes ekonomike ka kuptim vetëm nëse kujdesemi njëkohësisht që asnjë kategori e shoqërisë nuk mbetet jashtë dhe e pambrojtur. Duhet të sigurohemi që rritja e ekonomisë të jetë e qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse. Prezenca e mëtejme shqetësuese e varfërisë edhe atë në nivele të larta, mbetet vula më e pështirë e dy dekadave të fundit të qeverisjes. Si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen e angazhimit të qeverisë sonë, adresimi i problemit të varfërisë dhe ulja e saj mbetet kriter shumë i rëndësishëm me të cilin do të vlerësohemi. Qeveria jonë nuk do të lejojë që 100.000 bashkëqytetarë tanë të jetojnë me më pak se 1 euro në ditë. Si përmes politikave të punësimit sezonal, fondeve të ndara për gjetjen dhe mbështetjen e mundësive për punë sporadike dhe nga shtëpia të këtyre familjeve, masave të edukimit, apo rishikimit komplet të skemave të mbështetjes sociale, do të kujdesemi që të jemi pranë atyre që më së shumti kanë nevojë për dorën e publike. Njëherazi do të mundësojmë shpërndarjen e kuponëve monetarë, që do të mund të shfrytëzohen nga ana e përfituesve të ndihmave sociale, ekskluzivisht për blerjen e produkteve ushqimore esenciale të prodhuara në Kosovë.

Qeveria jonë ju siguron që do angazhohemi për kthimin e shpejtë të ekonomisë në normalitet dhe vendosjen e saj në trajektore të qëndrueshme të një zhvillimi dhe rritjeje afatgjatë por pa e rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale të vendit. Borxhi publik i vendit do të menaxhohet me nikoqirllëk në mënyrë që barra e bartur te gjeneratat e ardhshme të mbetet sa më e ulët.

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Krejt këto masa e angazhime besoj fuqishëm që do e ndihmojnë ekonominë e vendit dhe secilin prej nesh brenda saj. Por, natyrisht, se për përmirësim të vazhdueshëm të mirëqenies sonë do kemi nevojë për shumë më shumë ndërhyrje, shumë më shumë mbështetje. Do na duhen ndryshime domethënëse si në rëndësinë që ia atribuojmë buxhetit të shtetit, në mënyrën si i shohim politikat tona industriale e tregtare, politikat tona aktive e pasive në tregun e punës, mbështetjen e prodhimit vendor, tërheqjen e investimeve të huaja, politikat në arsim e shëndetësi, bujqësi e prokurim publik. Andaj krahas shqetësimit me të tashmen, qeveria jonë e ka njësoj të qartë edhe vizionin për të ardhmen. Në 50 ditët e qeverisjes sonë të mirë, ne kemi filluar të adresojmë një sërë masash, veprimesh e iniciativash ligjore që e mundësojnë ndryshimin rrënjësor aq të nevojshëm. Tani do ta kemi shumë më të lehtë të vazhdojmë me secilën prej tyre dhe të shtojmë vendime tjera, ashtu që lista e zotimeve tona të përmbushet në plotni.

ALBIN KURTI

Kandidat për Kryeministër



E ARDHMJA



Në fushën e ekonomisë dhe mbrojtjes sociale prioritetet e Qeverisë sonë të ardhshme do të jenë si më poshtë:

Do ta krijojmë Fondin Sovran dhe Bankën Zhvillimore të Republikës së Kosovës. Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës dhe do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së tyre.

Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të shuhet dhe asetet e saj do i kalojnë në pronësi Fondit Sovran.

Do të punojmë në krijimin e parakushteve që bëjnë të mundur avancimin e sektorit privat në faktor kyç të zhvillimit dhe punësimit. Për komunitetin e biznesit angazhohemi që të sigurojmë një ambient të barabartë veprimi, se do ua largojmë monopolet zhvatëse e konkurrencën e padrejtë, dhe se do të kryejmë pagesat me kohë për secilin kontraktim nga sektori publik, se do angazhohem që të kemi një sistem edukimi që prodhon shkathtësitë që kërkohen prej tyre, furnizim me energji të vazhdueshme dhe të përballueshme, një administratë publike që i mbështetë e nuk u kërkon ryshfet e nuk iu vendos haraç. Sepse pa ryshfet në fillim, e pa haraç në fitim, duhet të jetë e ardhmja e bizneseve tuaja.

Për punëtorët e punëtoret ne do të sigurohemi që ta kenë të garantuar kushtet e dinjitetshme të punës. Ne do të marrim masa që çdo vend pune të jetë me kontratë, me kontribute pensionale të paguara dhe jo më shumë se 40 orë pune të rregullt në javë. Gjithashtu do pesëfishojmë numrin e inspektorëve të punës, me synim parandalimin e diskriminimit të punëmarrësve dhe parandalimin e rreziqeve në punë. Do të fuqizojmë bashkëpunimin me sindikatat duke inkurajuar dhe ndihmuar punëtorët për organizim sindikal në të gjitha nivelet e punësimit. Pagën minimale planifikojmë ta rrisim në 250 euro, për angazhimin prej 40 orësh në muaj. Paga minimale do të përjashtohet nga tatimi në të ardhurat personale dhe që do të rishikohet vit për vit për të reflektuar ngritjen e të ardhurës kombëtare në vend.

Pushimi i lehonisë dhe ai prindëror në total do të jenë 12 muaj, ku

pjesëmarrës për pagesën do të jetë edhe shteti, dhe këtë mundësi do ta kenë të dy prindërit. Ndërsa për nënat që janë të papuna për 6 muajt e pushimit të lehonisë do t'u paguajmë pagën minimale prej 250 eurosh.

Për të rinjtë e rejat e vendit tonë ne kemi planifikuar krjimin e Skemës së Punësimit të Garantuar, ku moshat 16-18 vjeç do të kenë mundësinë e përfitimit të pagës dhe vendit të punës të garantuar nga shteti deri në një vit të plotë. Kjo do krijojë ambientin e nevojshëm për të mbjellë shprehinë e punës tek ata.

Përveç kësaj, e kemi konceptuar një paketë, që na siguron se talenti, dija dhe puna e rinisë do të optimalizohet duke e vendosur shtetin tonë në hartën botërore të inovacionit dhe teknologjisë. Për përforcimin e kësaj politike do ta themelojmë e jetësojmë një tekno-park, një fakultet për teknologji informative dhe hapësira për start-ups.

Për vajzat dhe djemtë nga i gjithë vendi që orientohen nga ndërmarrësia në këtë fushë, do të vihen në dispozicion deri në 2 mijë grante në vit, me një vlerë totale prej 20 milionë euro, destinuar për qira dhe pajisje. Kështu, për herë të parë dhe për çdo vit, 2.000 grupe entuziastësh të rinj do t'i kenë kushtet për t'i avancuar idetë e tyre.

Ne do ta mbështesim pa rezerva qeverisjen vendore komunale. Për këtë kemi hartuar një politikë krejt të re e transformuese. Prej keqpërdorimit të buxhetit qendror e trajtimit të pabarabartë të komunave do të kalojmë te krijimi i "Grantit të katërt" për komunat, që do të jetë granti për investime kapitale. Përmes këtij granti, në katër vitet e ardhshme, komunave do t'u alokohen mbi 600 milionë euro, dhe komunat do të vendosin vetë për alokimin e këtyre shumave për projekte të ndryshme kapitale, prej sistemeve të ngrohjes qendrore, zhvillimit ekonomik lokal, turizmit rural, mbështetjes së projekteve inovative, sporteve, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, artit, infrastrukturës publike, furnizimit me ujë të pijshëm e kanalizime.

Për familjet e prindërit kemi hartuar planin e sigurimit të banimit të përbalueshëm. Ky plan është konceptuar për shumë kategori shoqërore dhe grupe profesionistësh.

Ky plan i dedikohet çifteve të reja, grave kryefamiljare por edhe shërbyesve publik si arsimtarët, infermierët, policët, zjarrfikësit apo edhe administratën publike. Gjatë mandatit të parë të qeverisjes do të mundësojmë banim të përbalueshëm për 4.000 familje.

Kjo do të arrihet përmes programit "120x120" dhe "150x150", ku familjet përfituese do bëhen pronarë të banesave me këste mujore prej vetëm 120 respektivisht 150 eurove maksimumi dhe për një periudhë kohore prej jo më shumë se 150 muajve. Kostoja vjetore e këtij projekti është rreth 22 milionë euro, por kjo shumë gradualisht i kthehet institucionit i cili do të themelohet dhe ngarkohet me implementimin e projektit.

Njëkohësisht do të fillojë zbatimi i Programit të shtesave për fëmijët. Ne duam ta adresojmë situatën tonë demografike, ta shtojmë solidaritetin dhe ta çlirojmë gruan nga barra e madhe në kujdesin brenda familjes. Të gjithë fëmijët nën moshën 2 vjeçare do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 20 eurove, kurse për fëmijët nën moshën 16 vjeçare, shuma që përfitojnë do të jetë 10 euro në muaj. Shtesat për fëmijë do të paguhen në llogari të nënave anekënd Kosovës, do të lirohen nga çfarëdo obligimi tatimor si dhe nuk do të kihet parasysh gjatë përcaktimit të përfitimeve nga skemat tjera sociale në vend.

Të gjitha familjet që kanë të ardhura të ulta, do të rimbursohen varësisht prej të ardhurave vjetore që familja merr. Nga 50 euro për fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 7 mijë euro në vit, nga 100 euro për fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 6 mijë euro, dhe nga 150 euro për secilin fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 5 mijë euro.

Do të kujdesemi që për fëmijët të krijojmë vende të mjaftueshme në çerdhe duke i shtuar dhe 160 çerdhe në të gjithë vendin dhe shujta falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën. Kjo e kombinuar me arsimimin cilësor, bursa studimore dhe kurrikula që janë në hap me kërkesat e ekonomisë do ta transformojnë sistemin tonë të edukimit. Duke i ditur kushtet dhe vështirësitë e mijëra familjeve e qytetarëve tanë për ta regjistruar në emër të tyre pronën e trashëguar, do të hiqen të gjitha

pagesat dhe do të thjeshtohen procedurat për regjistrimin e pronës. Ne do të bëjmë edhe rishikimin e tarifave për shërbimet kadastrale dhe ato noteriale sa i përket regjistrimit të pronës së paluajtshme.

Do të kujdesemi që frutet e rritjes së mirëqenies shoqërore të shpërndahen në mënyrë sa më të barabartë midis të gjithë qytetarëve të vendit. Krahas rritjes së përfitimeve nga skemat sociale, dhe shtimit të buxhetit familjar përmes shtesave për fëmijë, do të kujdesemi që të implementojmë programe të punësimit sezonal për nga një anëtar të familjes për të gjithë ata që janë të përfshirë në skemat sociale.

Përmes rishikimit të legjislacionit ekzistues do të kujdesemi që targetimi të përmirësohet në mënyrë që askush në nevojë të mos mbetet jashtë ombrellës së mbështetjes sociale. Do dizenojmë intervenime shtesë që do shfrytëzojnë mundësitë për gjenerim të të ardhurave përmes aktiviteteve të kohëpaskohshme duke u kujdesur që të njëjtat të mos prekin përfitimet ekzistuese.

Për më të dashurit tanë, për të moshuarit që presin ndihmën tonë, do t'i ndërtojmë edhe 5 shtëpi të tjera me shërbimet e përkujdesjes për ta.

Një qeveri e qytetarëve i ka sytë te më të rrezikuarit. Kështu që jemi përgatitur që ta rrisim si kurrë më parë angazhimin për t'i shkolluar në të gjitha nivelet fëmijët e të rinjtë nga komunitetet romë, ashkali e egjiptas. Ne e dimë që ka paragjykime por ato thyhen në shkollë e me shkollim.

Të vetëdijshëm që ndihma sociale nuk e transformon gjendjen ne do të veprojmë me dy hapa. Së pari do ta japim këtë ndihmë për familjet të cilët i kanë fëmijët nxënës nga parashkollori deri në klasën e 12-të. Dhe, hapi i dytë është aftësimi për punësim.

Për këtë na nevojitet dhe rritja e numrit të mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve në nevojë.

Ne do ta ndërrojmë në themel politikën e granteve dhe subvencioneve. Mbështetja financiare do të shtrihet deri te përpunimi i ushqimeve duke

siguruar këshillim dhe orientime në prodhime me potencial të lartë ekonomik. Do t'i sigurohet treg prodhimit të subvencionuar, e do ta jetësojmë sigurimin e prodhimit.

Në mënyrë që të sigurojmë një treg vendor që nuk përbuz mundin e fermerëve, do të sigurohemi që të ketë çmim dysHEME për kulturat kryesore bujqësore e blegtorale kësisoj, shteti garanton blerjen në njërën anë dhe mbush rezervat shtetërore në anën tjetër.

Do të punojmë për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë, që i hap Kosovës mundësi shtesë për të përfituar mbështetje në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe do ta financojmë bujqësinë për çdo vit deri në 100 milionë euro.

Para mërgatës sonë zotohem se do jemi gjithmonë falenderues për mbështetjen e pa rezervë që na kanë ofruar sa herë që kombi ka pasur nevojë. Me qeverisjen tonë, mërgata do të avancohet në hisenik si të përpilimit të politikave tona ashtu edhe në implementimin e tyre. Nuk do ketë më karton të gjelbërt për mërgatën dhe nuk do ketë më maltretime për ta sa herë që duan të ushtrojnë apo konsumojnë të drejtat e tyre si qytetarë të republikës.

Qeveria jonë do ta trajtojë sportin si prioritet shtetëror. Do të financojmë projektet e qendrave multifunkionale sportive, me buxhet vjetor prej 15 milionë euro. Afër kryeqytetit do të ndërtojmë qendrën më të madhe multifunkionale, pjesë e së cilës do të jetë edhe stadiumi nacional, si dhe një program intensiv për të mbështetur financiarisht shkollat e sportit me theks edukimin sportiv të moshave të hershme. Përveç ndërtimit të stadiumit kryesor e të cilin do ta përfundojmë e funksionalizojmë, ne angazhohemi për edukimin e fëmijëve me sportin. Kjo na garanton që e zbulojmë dhe mbështesim talentin kudo që ai paraqitet në shkollat e sporteve.

Do të sigurojmë një model të ri të qeverisjes së resurseve tona minerare. Do të mundësojmë ringritjen dhe avancimin duke riparuar kapacitetet ekzistuese, duke futur teknologjinë e re dhe duke zhvilluar metalurgjinë dhe kiminë, vazhdimisht me planin e masave për mbrojtjen maksimale

nga ndotja. Në Trepçë do ta shtojmë prodhimin e hulumtimit si dhe kualifikimin e punëtorëve. Zhvillimi i Trepçës është në mesin e hapave më të rëndësishëm për bashkimin e qytetit të Mitrovicës të ndarë në dy komuna.

Pakti ynë për mbrojtjen e mjedisit do të jetë udhëzues në mënyrë që të sigurohemi se rritja ekonomike do të shkojë krahas e jo në kurriz të mbrojtjes së burimeve tona natyrore. Do të avancojmë kornizën ligjore që mundëson mbrojtjen efektive të shtretërve të lumenjve si nga kapja ilegale e rrjedhave ujore, ashtu edhe nga keqpërdorimi i rezervuarëve natyrorë dhe artificial. Do të kujdesemi për një planifikim hapësinor që vendos rregullin për zhvillim ekonomik të baraspeshuar, shfrytëzim racional të resurseve dhe hapësirës, barazi, lëvizje të lirë, qasje të lehtë në shërbime publike dhe kohezion shoqëror.

Ne angazhohemi që deri në vitin 2025 ta zgjidhim çështjen e rrjetit të kanalizimeve në të gjithë vendin përfshirë dhe fshatrat tanë.

Korridoret rrugore kombëtare si Deçan-Plavë, Prizren-Tetovë, Gjakovë-Shkodër, si dhe projektin për lidhjen hekurudhore Prizren-Durrës do t'i nënshtrohen planeve të detajizuara hapësinore.

Aeroporti i Gjakovës do të funksionalizohet me dy shërbime bazë, kargo dhe për udhëtime me kosto të ultë. Shërbimet që lidhen me pjesën e dedikuar për FSK dhe veprimtari të ngjashme do të jenë të dedikuara për ta.



127 - Lëvizja **VETËVENDOSJE!**

SHKOLLA – EKONOMIA – UNIVERSITETI





“Prioriteti ynë kryesor është përfshirja sa më e madhe e fëmijëve në edukimin e hershëm.”

Prioriteti ynë kryesor është përfshirja sa më e madhe e fëmijëve në edukimin e hershëm. Kjo do të arrihet duke ndërtuar objekte të reja të edukimit të hershëm, si dhe duke i përshtatur objektet ekzistuese e të pashfrytëzuara për këtë qëllim. Ndërkaq, masa kryesore do të jetë largimi i pagesës për edukimin e hershëm për fëmijët që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta ekonomike. Ne do të përsosim kurrikulën në edukimin e hershëm duke e orientuar atë nga aftësitë vetërregulluese të fëmijëve dhe do të ofrojmë mbështetje të vazhdueshme profesionale për mesimdhënësit në zbatimin e saj.

Në arsimin fillor do të ndryshojmë rrënjësisht paradigmen, duke e larguar notimin diferencial për klasat 1 deri 4 dhe për të zëvendësuar atë me vlerësimin formativ. Në arsimin parauniversitar logjika gjuhësore, logjika matematikore dhe mendimi kritik do të jenë pjesë e praktikave të mesimdhënies në të gjitha nivelet. Gradualisht, do të lëvizim në drejtim të digjitalizimit të arsimit dhe krijimit të klasave të së ardhmes.

Parakusht për rritjen e cilësisë në arsim është mbështetja e mesimdhënësve në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mesimdhënësve. Ne do të krijojmë bibliotekat e mesimdhënësve në secilën shkollë duke i pajisur ato me literaturën relevante dhe të kohës. Për mesimdhënësit do të ofrojmë edhe banimin me kosto të përballeshme. Në bashkëpunim me mesimdhënësit do të sigurojmë një model të shpërblimit të performancës.

Një intervenim tjetër i rëndësishëm do të realizohet në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional. Ne do të nxisim sinkroninë mes arsimit profesional dhe ekonomisë së vendit. Për këtë duhet t'i avancojmë profilet e shkollave të mesme profesionale me profesione për të cilat ka kërkesë për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Shkollat profesionale do të pajisen me punëtorë për realizimin e punës praktike, ndërsa do të punohet me ndërmarrësit në organizimin e të mësuarit në vendin e punës.

Kërkimit shkencor do t'i hapet një perspektivë e re, që do të fillojë me përcaktimin e prioriteteve shtetërore. Universitetet do t'i fuqizojmë drejt kërkimit shkencor me Fondin e Hulumtimeve që e themelojmë për herë të parë dedikuar kërkuesve, ligjëruesve, profesorëve e specialistëve mjekësorë, hulumtime këto që do të kthehen në evidencë për politikbërjen.

Ne zotohemi se me shumicën tonë parlamentare dhe komptencat tona ekzekutive do të angazhohemi për të rishqyrtuar dhe miratuar politikat e sigurimit të cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Pavarësia profesionale dhe funksionale e Këshillit Shtetëror të Cilësisë është e pacenueshme. Ata do të kenë mbështetjen e qeverisë për kërkesat në burime njerëzore e buxhetore. Angazhimi ynë do të orientohet në rianëtarësimin e Kosovës në ENQA dhe EQAR.

Ne jemi studentët tanë. Nuk mundemi të qeverisim pa studentët në mendje. Qeverisja do të stimuloj angazhimin e studentëve nëpërmjet punës praktike në të gjitha institucionet publike në vend. Ne do të lehtësojmë procedurat e angazhimit vullnetar të studentëve dhe do të njohim këtë angazhim si përvojë të punës. Ne jemi për arsim publik falas. Në institucionet publike do të hiqen tarifat për pagesën e semestrit. Buxhetimi i bursave studentore do të avancohet. Por ne planifikojmë që të fuqizojmë e mbështesim vajzat, andaj zotohemi të sigurojmë 1000 bursa studentore me prioritet ato që zgjedhin të studiojnë shkencat teknike e natyrore, brenda e jashtë vendit.

**“Qeverisja
do të
stimuloj
angazhimin
e studentëve
nëpërmjet
punës
praktike në
të gjitha
institucionet
publike në
vend.”**



SHËNDETI PUBLIK

127 - Lëvizja **VETËVENDOSJE!**





Për shumë gjatë shëndetësia u shqua si një nga sektorët më të keqmenaxhuar. As pacientët nuk i marrin shërbimet e sigurta por as profesionistët shëndetësor nuk i kanë kushtet elementare për punë. Pandemia COVID-19 e shpërfaqti brutalisht pamundësinë e sistemit tonë për të ofruar shërbimet më bazike shëndetësore.

Ne ia nisëm por edhe do ta ndërtojmë sistemin shëndetësor me standarde të vendosura qartë dhe monitorim të vazhdueshëm që eliminojnë pabarazitë. Funkcionalizimi i sigurimeve shëndetësore publike është detyrë e jonë për të cilën zotohem para jush se do të përmbushet.

Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, pacientëve tanë, e punonjësve shëndetësor nuk do t'i mungojnë mjetet e barnat. Qendra Klinike Universitare ka nevojë për një ritëm të ri, në hap me kohën dhe me nevojat e mëdha që kemi. Nuk do të ketë më spitale rajonale të harruara, jashtë vëmendjes dhe buxhetit.

Lista esenciale e barnave do të buxhetohet ashtu që për rezultat të kemi të gjitha barnat nga kjo listë e cilësisë më të lartë të mundshme. Prandaj, përveç racionalizimit do të rritet edhe buxheti për shëndetësi. Çdo vit buxhetit për shëndetësi do t'i shtohen 40 milionë euro. Kjo do të përmisojë edhe infrastrukturën e kushtet e punës për personelin shëndetësor.

Do të investohet në zhvillimin mjekësisë preventive, në atë shkollore dhe shumë më shumë se deri tani në mjekësinë familjare.

Do ta bëjmë rritjen e bashkëpunimit midis Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe shërbimit primar, që është hallka e parë e sistemit shëndetësor në drejtim të promovimit të shëndetit. Dhe, zhvillimin dhe funksionalizimin e plotë të IKShP-së e bashkëpunim me shërbimet tjera shëndetësore vendore dhe organizmat ndërkombëtarë. Edukim dhe aftësim i stafit të IKShP-së, si dhe përkrahje institucionale dhe materiale për përpilimin e një strategjie për rreziqet, nevojat dhe

**Sigurime
shëndetësore
publike.**

sugjerimet për shëndetin publik. Kjo strategji duhet të jetë bazë e politikave shëndetësore në drejtim të parandalimit të sëmundjeve dhe investimeve në segmente prioritare.

Do të rrisim numrin e qendrave dhe shërbimeve të shëndetit mendor, dhe të bëjmë përmirësimin teknik të qendrave ekzistuese. Si dhe rritjen e numrit të profesionistëve për parandalimin dhe mjekimin adekuat të këtyre sëmundjeve.

Do të rrisim numrin e qendrave dhe shërbimeve për gjendje të caktuara si autizmi, sindromi Down etj. Dhe zhvillimin e promovimin e programeve për zvogëlimin e paraqitjes së sëmundjeve profesionale.

**“Çdo vit
buxhetit për
shëndetësi
do t’i
shtohen
40 milionë
euro.”**



E DREJTA E DREJTËSIA

"...nivelet më të larta hierarkike të sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm, do t'i nënshtrohen procesit të vetingut."

Pjesë integrale dhe e domosdoshme e sistemit të drejtësisë është gjyqësori i pavarur, i paanshëm, me integritet dhe efikas. Për të arritur këtë, nivelet më të larta hierarkike të sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm, do t'i nënshtrohen procesit të vetingut. Nëpërmjet këtij procesi synohet të arrihet integriteti gjyqësor dhe prokurorial dhe do të kthehet besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këshillave, procesi i vetingut do të nisë nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial.

Do të fuqizohet mekanizmi i ndihmës cilësore juridike për qytetarët. Do të bëhen plotësime në Ligjin për Ndihmë Juridike Falas me qëllim që të drejtën për përfaqësim pranë gjykatave ta kenë edhe viktimat e dhunës në familje apo dhunës në baza gjinore si dhe dhunës seksuale, por po ashtu edhe në rastet civile të divorceve, amësisë, apo çështjet e trashëgimisë dhe ndarjes së pasurisë së përbashkët.

Qeveria jonë do të dëshmojë përkushtim në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe në këtë drejtim do të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale në departamentin special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit. Kjo do të mundësohet përmes mbështetjes financiare për sistemin e drejtësisë me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre.

Po ashtu do të punohet në drejtim të krijimit të Gjykatës Administrative dhe asaj të Punës. Krijimi i këtyre Gjykatave të reja me sistem elektronik për menaxhimin e lëndëve, me numër të nevojshëm gjyqtarësh të profesionalizuar në fushat përkatëse, do dëshmonte rezultate të prekshme në praktikë.

Qeveria do të hartojë projektligjin për realizimin e të drejtave civile, me anë të së cilit synohet shkurtimi i afateve procedurale për zgjidhjen e kontesteve civile, transformimi i sistemit të bashkëpunëtorëve profesionalë që vlerësojnë kontestet, e sanksionet penale ndaj gjyqtarëve për mosrespektim të afateve.

Krahas vlerësimit të nevojave në sistemin gjyqësor, duke pasur parasysh rëndësinë, Qeveria do të shtoj kapacitetet e Prokurorisë Speciale. Prokurorët e Prokurorisë Speciale do të jenë të ndarë në departamente dhe do të ketë trajnime dhe profilizime të tyre varësisht nga veprat që hetojnë.

Do të fuqizohet departamenti për krime lufte brenda prokurorisë speciale. Ky departament do të mbështetet me prokurorë të rinj dhe bashkëpunëtorë profesional dhe do të angazhohemi për rishikimin e kurrikulës së trajnimeve brenda Akademisë së Drejtësisë si dhe shtimin e trajnimeve të veçanta e të specializuara brenda Akademisë së Drejtësisë për hetimin dhe trajtimin e rasteve të krimeve të luftës duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tyre.

Po ashtu, do të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale edhe në departamentet për krim të organizuar, korrupsion dhe krime financiare në kuadër të Prokurorisë Speciale duke pasur parasysh përkushtimin tonë për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Numri i prokurorëve në Prokurorinë speciale dhe bashkëpunëtorëve profesional në raport me lëndët që trajtohen në këtë prokurori është shumë i vogël.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe specifikat e veçanta të Administratës së sistemi të drejtësisë, do të procedohet në Kuvend projektligji që rregullon statusin e administratës së sistemit të drejtësisë.

“do të shtohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale edhe në departamentet për krim të organizuar.”





127 - Lëvizja **VETËVENDOSJE!**

ADRESIMI I KRIMEVE TË LUFTËS



“Përgatitjen e një platforme reparative për krimet e kryera gjatë luftës.”


Do të përkushtohemi në adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës (krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi), matjen e dëmeve të shkaktuara gjatë luftës në njerëz, komunitet, ambient dhe ekonomi e gjithashtu në përgatitjen e një platforme reparative për krimet e kryera gjatë luftës.

Prioritet i Qeverisë do të jetë përgatitja e padisë ndaj krimit të gjenocidit të Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Qeveria në bashkëpunim me të gjithë personat dhe grupimet dhe organizatat për ngritjen në nivele ndërkombëtare të kërkimit të drejtësisë për krimet e luftës dhe gjenocidit në Kosovë, duke synuar anëtarësimin e Kosovës në Konventat e Gjenevës dhe Konventën kundër Gjenocidit, si dhe mundësinë e ushtrimit të padisë së Kosovës kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Për realizimin e këtyre synimeve, do të ndërmarrim hapat në vijim, me dedikim financiar adekuat dhe përgjegjësi institucionale për realizimin e këtyre pikave, duke mos përjashtuar ndryshime dhe plotësime në përputhje me kontekstin politik.

- Themelimi me ligj, i financuar në mënyrë adekuate, i Institutit për hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës, me mision të përcaktuar qartë, financim adekuat dhe me njerëz profesionistë dhe kompetentë.
- Respektimi dhe zbatimi i gjykimit në mungesë të kriminelëve të luftës sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
- Krijimi i një komisioni parlamentar të përhershëm për krimet e kryera gjatë luftës, krimet kundër njerëzimit, dhe krimin e gjenocidit dhe për dëmet e shkaktuara në Kosovë.
- Fuqizimi i departamentit për krime lufte brenda Prokurorisë Speciale me një numër të mjaftueshëm prokurorësh dhe bashkëpunëtorësh të mirë-trajnuar.
- Rishikimi i mandatit të departamentit special brenda Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit me qëllim të fuqizimit të tij dhe qartësisimit



të kompetencave për lëndët e prokurorisë speciale.

- Krijimi i një njësie të veçantë e të specializuar brenda Agjensisë së Kosovës për Forenzikë, që i verifikon shkencërisht faktet dhe dëshmitë.

- Miratimi i një legjislacioni të veçantë për mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave të viktimave të krimeve në Kosovë.

- Krijimi i një dege të veçantë/katedre brenda Universitetit të Prishtinës, në Fakultetin Juridik, për edukimin dhe specializimin e profesionistëve për këto çështje dhe mbështetja për edukim të vazhdueshëm brenda e jashtë vendit.

**“Prioritet i
Qeverisë do të
jetë përgatitja
e padisë
ndaj krimit
të gjenocidit
të Serbisë
në Gjykatën
Ndërkombëtare
të Drejtësisë.”**



**SIGURI
PUBLIKE
QYTETARËVE
—
MBËSHTETJE
POLICËVE**





"...zyrtarëve policorë do t'u garantohet e drejta e pensionimit të parakohshëm në moshën 55 vjeçare."

Reformat në Policinë e Kosovës do t'i fillojmë menjëherë me miratimin e Ligjit për Pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë. Me këtë ligj, zyrtarëve policorë do t'u garantohet e drejta e pensionimit të parakohshëm në moshën 55 vjeçare. Në mënyrë që të mos dëmtohet funksionimi i rregullt i Policisë së Kosovës, zbatimi i ligjit do të ndahet në disa faza, në të cilat policët që e shfrytëzojnë të drejtën e pensionimit të parakohshëm do të zëvendësohen gradualisht përmes rekrutimit të mbi 2.000 zyrtarëve të rinj policorë.

Njëjtë sikurse Policia e Kosovës na japin neve siguri, edhe ne duhet t'u japim zyrtarëve policorë sigurimin jetësor e shëndetësor si një e drejtë e garantuar për punën e tyre të rëndësishme por edhe nën rrezik. Paralelisht, do t'ia japim Policisë së Kosovës kapacitetet e domosdoshme materiale, që të ketë mundësi të kryejë punën e vet në mënyrën më efikase të mundshme. Në këtë drejtim, do t'i shtojmë investime flotës policore, si dhe në infrastrukturën dhe teknologjitë e nevojshme për luftimin e krimit, korrupsionit, si dhe ruajtjen e kufirit ajror e tokësor të vendit.

Forcimi i integritetit dhe profesionalizmit në Policinë e Kosovës do të jetë ndër objektivat tona kryesore. Nivelet e larta drejtuese të policisë do t'i nënshtrohen procesit të vetingut, i cili do të zbatohet në të gjitha institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në vend. Do të sigurohemi që, jo vetëm Inspektorati Policor i Kosovës si mbikëqyrës i jashtëm, por edhe mekanizmat e brendshëm të kontrollit si Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe Departamenti i Auditimit e Prokurimit, të kenë pavarësinë e plotë në ushtrimin e rolit të tyre. Duke siguruar këtë pavarësi të plotë, do të vendosim themele të forta dhe qëndrueshme për integritetin policor, zbatimin transparent të ligjit dhe llogaridhënien e repte brenda dhe jashtë Policisë.

Ndër rezultatet më të rëndësishme të forcimit të integritetit dhe profesionalizmit, do të jetë vlerësimi dhe gradimi i bazuar ekskluzivisht në meritat e kandidatëve përkatëse, sipas kritereve objektive dhe

transparente dhe duke iu referuar praktikave më të mira ndërkombëtare. Koha e gradimit në bazë të nepotizmit dhe ndikimit politik do të marrë fund në Qeverinë tonë.

Forcimi i Policisë do të jetë edhe në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe dhunës familjare. Vetëm me këtë forcim të integritetit dhe profesionalizmit, Policia e Kosovës do të jetë në gjendje për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të luftuar korrupsionin në institucionet e tjera shtetërore dhe në shoqëri më gjerësisht. Luftimi i krimit të organizuar dhe trafikimit me qenie njerëzore do të jetë prioritet i Qeverisë sonë. Si hap i parë, do të punojmë drejt shkëputjes së lidhjeve kriminale ndërmjet zyrtarëve shtetërorë dhe krimit të organizuar. Për të arritur këtë qëllim, do të forcojmë shtyllën e hetimeve brenda Policisë, duke rritur numrin e hetuesve policor si dhe do të sigurojmë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre.

Me qëllim të rritjes së sigurisë në vend, do ta forcojmë bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe Policisë në komunitet dhe, nga ana tjetër, do të forcojmë gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sigurisë për të luftuar krimin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore dhe terrorizmin.

Prioritet tjetër i yni do të jetë mbrojtja e minoriteteve, si dhe parandalimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Përmes trajnimeve të zyrtarëve policorë, do të punojmë për të përmirësuar mendësinë e institucioneve të zbatimit të ligjit, në mënyrë që dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave ta trajtojnë si vepër penale që është dhe, si e tillë, ta ndëshkojnë me forcën e plotë të ligjit.

**“Forcimi i
Policisë do
të jetë edhe
në luftën
kundër
krimit të
organizuar,
korrupsionit
dhe dhunës
në familje.”**



MBROJTJA DHE FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS





Ne do t'i japim përparësi gatishmërisë luftarake të FSK-së ashtu siç e ka misionin dhe detyrën. Qeverisja jonë do t'i orientoj politikat e mbrojtjes në zhvillimin e kapaciteteve për të përmbushur detyrën parësore të FSK-së atë të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.

Do të ketë thellim dhe rritje të bashkëpunimit bilateral me partnerët strategjik në krijimin e aftësive dhe kapaciteteve të plota ushtarake theks të veçantë me Shqipërinë dhe ShBA-të. Ne do të përgatitemi për ta bërë Kosovën anëtare të Kartës së Adriatikut.

Dhe, në bashkëpunim të ngushtë më Aleancën e Atlantikut Verior ta kompletojmë Forcën e Sigurisë me tiparet e ushtrive simotra.

Ne do të përgatisim planin për shërbimin ushtarak të kombinuar në 3+3 muaj për të rinjtë tanë duke u kujdesur për shtimin e kapaciteteve trajnuese dhe edukuese të FSK-së.

“Ne do t'i japim përparësi gatishmërisë luftarake të FSK-së ashtu siç e ka misionin dhe detyrën.”



127 - Lëvizja VETËVENDOSJE!

KOSOVA ME POLITIKË TË JASHTME





Politikat tona të brendshme dhe ato të jashtme do të jenë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Fuqizimi i shtetit tonë brenda është kusht për ta faktorizuar atë jashtë. Ne jemi për vlerat e parimet e bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe parimeve reciproke të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Andaj zotohemi për të vijuar me politikë të jashtme aktive, inovative parimore.

Me partnerët tanë strategjik si Shqipëria, ShBA, vendet e Bashkimit Evropian dhe Britania e Madhe na duhet të shtojmë fushat e bashkëpunimit sikundër dhe koordinimin për t'i mbërritur synimet tona.

Ne i konsiderojmë politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë si vektorë të politikës së jashtme. Si kurrë më parë do ta organizojmë diplomacinë përmes artistëve, sportistëve e ndërmjet qyteteve.

Këto synime kërkojnë shpejtësi veprimi e mprehtësi planifikimi. Andaj vëmendja jonë për shërbimin diplomatik do të pasohet me reforma të thella, me fuqizimin e Akademisë Diplomatike, verifikimin e gradave, kthimin e mundësisë për diplomatët e karrierës që ta vijojnë ecjen e tyre para në përfaqësimin me dinjitet të Republikës. Dinjitetin e diplomatëve tanë do ta sigurojmë edhe nëpërmjet reformave legjislative, ku do të garantohet mirëqenia e tyre në raport me kushtet e jetesës së vendit pritës.

“Bashkimi Evropian është bashkim me dijen dhe zhvillimin.”

Bashkimi Evropian është bashkim me dijen dhe zhvillimin. Do ta rikthejmë adresën politike të Kosovës për BE-në, pra Ministrinë e Integritit. Bashkëpunimi me shtetet kryesore të BE-së dhe vendet e tjera anëtare me të cilat nuk ka ende marrëdhënie të thelluara bilaterale do të jetë një nga veprimet më të para të qeverisë sonë. Por, ne e duam dhe do ta sjellim europianizmin nëpërmjet bashkëpunimit intensiv për të marrë dijen, projektet e ekspertizën si fuqizim i arsimit profesional si dhe mbështetjen për realizimin e paktit për mjedisin. Ne i duam standardet e Bashkimit Evropian edhe për profesionistët tanë në institucionet e

ndërmarrjet publike andaj do të organizojmë specializimin e tyre drejt vendeve ku ky zhvillim i hovshëm ka ndodhur.

Bashkimi Evropian ndan për Kosovën Fondet IPA. Ne do të punojmë me ta që planifikimi i fondeve të shkojë në vijë me strategjinë tonë të zhvillimit, më kërkesat e vendit tonë pra për arsimin, shkencën, shëndetësinë, aftësim profesional, bujqësinë e mjedisin. Kështu ne mund të përgatitemi në të ardhmen për aplikimin për statusin e shtetit kandidat.

Bashkëpunimi me Shqipërinë do të shprehet në mekanizma të përbashkët për interesin kombëtar dhe të mirën e përbashkët. Do të krijojmë regjistra të përbashkët civilë dhe biznesorë, qarkullim e bashkëpunim pa pengesa të qytetarëve, profesionistëve dhe prodhimeve, si dhe komisione të përbashkëta qeveritare dhe parlamentare për siguri kombëtare, politike të jashtme, burime natyrore.

“Bashkëpunimi me Shqipërinë do të shprehet në mekanizma të përbashkët për interesin kombëtar dhe të mirën e përbashkët.”



INSTITUCIONET E ARTIT DHE ARTISTËVE



Institucionet e artit do të kenë buxhet vetjak dhe të qëndrueshëm. Teatri Kombëtar dhe teatrot e qyteteve do të kenë të garantuar financimin e rregullt dhe fondin e shtuar për projektet artistike. Njëjtë dhe për baletin, ansamblin dhe institucionet e tjera.

Do ta themelojmë Teatrin e Operas dhe Baletit si institucion të vetëqëndrueshëm. Si dhe do të fillojmë të ideojmë Teatrin e ri Kombëtar. Ne do t'i japim prioritet buxhetimit serioz të institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore. Subvencionet do të shumëfishohen por kryesisht për skenën e pavarur. Kosova për herë të parë do të ketë ndërtesë të dinjitetshme për operë dhe balet. Do të krijohen mundësi të reja për zhvillimin e kulturës përmes fondit të rritur për kulturën e pavarur. Shikueshmëria e filmit do të rritet dhe nxitet përmes formimit të kinemave të reja në komunat e Kosovës, me një program të veçantë për investime në infrastrukturë, dhe me mbështetje për programacion filmik.

Do t'i këndellim muzetë. Ekspozatat në Kosovë do të regjistrohen me standarde ndërkombëtare dhe të ekspozohen sipas konventave më bashkëkohore. Ndër projektet konkrete që do të trajtohen me prioritet janë: Muzeu i Historisë së Natyrës, Muzeu i Burgut të Prishtinës, Muzeu Arkeologjik, dhe zhvillimi i projekteve të tjera muzeale kombëtare dhe komunale.


“Do ta themelojmë Teatrin e Operas dhe Baletit si institucion të vetëqëndrueshëm.”



TRASHËGIMIA KULTURORE

127 - Lëvizja VETËVENDOSJE!





“Shpëtimi i trashëgimisë në rrezik do bëhet përmes ndërhyrjeve emergjente dhe fuqizimit të inspektoriatit.”

Shpëtimi i trashëgimisë në rrezik do bëhet përmes ndërhyrjeve emergjente dhe fuqizimit të inspektoriatit. Si hap i parë themelohet fondi për ndërhyrje emergjente për të shpëtuar mbi 100 asete të listës “trashëgimia në rrezik”. Krahas “ndihmës së parë”, do të fuqizohet inspektoriatit për të siguruar mbikëqyrje efektive dhe parandalim të aktiviteteve që çenojnë asetet e trashëgimisë.

Do të kemi mbrojtje e përhershme ligjore e aseteve të trashëgimisë kulturore. Në afatin optimal dokumentohen të gjitha burimet e trashëgimisë kulturore me synim pasurimin e inventarit të aseteve. Paralelisht procedojmë me shpalljen e aseteve të trashëgimisë në mbrojtje të përhershme ligjore, duke përcaktuar autenticitetin, perimetrin e zonës dhe përshkrimin e kufizimeve.

Do të kemi përfshirje të trashëgimisë në plane hapësinore për të kontrolluar aktivitetin ndërtues brenda zonave të mbrojtura. Trashëgimia pra do të përfshihet në dokumentet hapësinore. Me rëndësi primare është përfshirja e zonave të trashëgimisë në Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës dhe Regjistrin Kadastral (planet kadastrale). Njëjtë do të veprohet edhe me dokumentet hapësinore të komunave për të kufizuar dhe kontrolluar aktivitetin ndërtues brenda këtyre zonave.



SPORTI PRIORITET SHTETËROR





**“Përveç
buxhetit për
investime të
mëdha
nacionale –
ndërtimin e
Stadiumit,
pishinës
Olimpikë, dhe
qendrës multi-
funksionale”**

Politikat dhe programet zhvillimore të sportit do të kenë në fokus talentin sportiv dhe qytetarin aktiv. Për të implementuar programet tona, ne do të angazhohemi për strukturim dhe qeverisje të mirë të institucioneve dhe organizatave sportive.

Përveç buxhetit për investime të mëdha nacionale – ndërtimin e Stadiumit, pishinës Olimpikë, dhe qendrës multifunksionale, ne do të sigurojmë hapësirat e nevojshme për stërvitje dhe zhvillim të sportit rekreacional/shëndetësorë. Renovimi i sallave dhe terreneve sportive ekzistuese në zonat urbane e rurale është strategji e jona për zhvillim të infrastrukturës së objekteve sportive.

Për ngritjen e kapaciteteve të sportit profesional, ne do të financojmë programe të nivelit shtetëror për trajnimin dhe zhvillimin e trajnerëve, programe për identifikimin dhe zhvillimin e talentëve në sport, organizimin e garave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe mëshitetjen e klubeve sportive dhe sportistëve gjatë dhe pas karrierës së tyre.

Prioritet tjetër i yni është fuqizimi i aktivitetit fizik si mjet për ruajtjen e mirëqenjes së shoqërisë tonë si tërësi. Për zhvillimin e kësaj politike që përfshin rritjen e numrit të qytetarëve aktiv, ne do të themelojmë departamentin e sportit për të gjithë. Departamenti do të koordinojë programe të përbashkëta me sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Edukimi i hershëm për benefitet e aktivitetit fizik është esencial për transformimin e sportit si pjesë të kulturës tonë qytetare.

Andaj, intervenimet për zhvillim do të bëhen nga niveli parashkollor deri te ai universitar. Për implementimin e politikave tona strategjike, ne do të ndajmë buxhet të veçantë për inkurajimin dhe financimin e projekteve me qëllim të gjithëpërfshirjes së qytetarëve në aktivitet fizik pa dallim moshe, gjinie, apo statusi social-ekonomik.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

I kemi dëshirën dhe vullnetin, guximin dhe besimin, idetë dhe planet.
Jemi shpresa e njëri-tjetrit. Andaj, krejt bashkë, drejt Kosovës që e duam,
që na duhet, e që i duhemi.

Ju falemnderit!



ALBIN KURTI

